



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Në mbështetje të nenit 63.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjit për Pyjet e Kosovës, 2003/3, Ligjit Nr.03/L-153 mbi Plotësim Ndryshim të Ligjit Nr.2003/3, nenit 9 pika 1,2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2010, duke marrë për bazë aktin përcjellës të Agjencionit Pyjor të Kosovës me nr.Ref: PR/APK-371/23, shpallë këtë:

NJOFTIM

1. Njoftohen të gjithë të interesuarit se lejohet prerja e 189.70m³ trugjeve pyjore për furnizimin e 27 ekonomive familjare me lëndë djegëse me nga 7m³ në zonën rurale Bradash sipas kriterëve të parapara me Udhëzimin Administrativ Nr.14/2011 të datës 10.08.2011.
2. Drejtoria formon komisionin për pranimin e kërkesave, mbikëqyrin prerjen, tërheqjen dhe transportin e prerjeve sanitare të trugjeve në ngastrën nr.152-0, Njësia Menaxhuese Popovë-Lllapashticë, sipas Planit Vjetor Menaxhues me Pyje për Vitin 2023.
3. Shitja e produkteve drusore në cuç bëhet sipas Librit të Damkosjes së Trugjeve sipas planit për prerje të Agjencionit Pyjor të Kosovës me nr.Ref:PR/APK-371/23-1 të datës 10.08.2023, me çmim prej 18.84 €/m³.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset stafi i DBPZHR, në bashkëpunim dhe koordinimin edhe me zyrtarë të tjerë të shërbimeve të tjera të Komunës.
5. Përparësi kanë banorët e atij lokacioni.
6. Me rastin e aplikimit duhet të bashkangjitet kopja e leternjoftimit të aplikuesit si dhe kërkesa e plotësuar.

Pranimi i kërkesave bëhet në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve duke filluar nga data 20.09.2023 deri me datë 06.10.2023 ora 8:00-16:00, ndërsa prerja, tërheqja dhe transportimi i asortimenteve drusore bëhet në afatin prej 10 ditësh duke filluar nga data e lidhjes së kontratave (me përjashtim nëse kushtet klimatike nuk e mundësojnë).

SQARIM

Bazë e këtij njoftimi janë planifikimet e ndërhyrjeve silvikulturore të aprovuara me Planin Vjetor Menaxhues me Pyje për Vitin 2023.

Preventivë e mos përhapjes së sëmundjeve dhe dëmtuesve pyjore, përmirësimit të gjendjes shëndetësore dhe strukturës sa më kualitative të përbërjes pyjore si dhe nevojave të ekonomive familjare në zonat rurale për ngrohje.

Njoftimi i dërgohet:

- Arkivit të DBPZHR dhe
- Arkivit APK.

Podujevë, 20.09.2023

Nr. 12-320/01-0069942/23

Zyrtare për Pylltari, Majlinda Gashi M Gashi

